

Shpjegim i "Libri i teuhidit" – 64

(E drejta e Allahut ndaj njerëzve)

Mësimet të mbajtura nga dijetari i njohur Salih Ibn Abdul Aziz Muhamed Ali Shejh

(Allahu e faltë atë, prindërit e tij dhe të gjithë muslimanët!)

Përkthyes: Bilbil Talla

Redaktor: Ilir Haxhiaj

Kapitulli: Betimet ndaj Allahut

Xhundub Ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë:

“Njëherë, një njeri tha: “Vallahi, Allahu nuk e fal filanin!” Allahu i Lartësuar tha: “Kush është ai që betohet në Mua se nuk e fal filanin?! Në të vërtetë, Unë e fal atë dhe ta asgjësoj punën tënde”¹.

Sipas hadithit të Ebu Hurejrës, tregohet se ai ishte një njeri i zellshëm në ibadet, por - thotë Ebu Hurejra- ai shprehu një fjalë që i shkatërroi dynjanë dhe ahiretin”².

Dobitë e temës

- Paralajmërimi ndaj betimit të Allahut.
- Fakti se zjarri është më afër nesh sesa rripi i sandales.
- Fakti se po kaq afër është edhe xheneti.
- Dëshmi për këtë është thënia e Profetit (Paqja e Allahut qoftë mbi të!): “Dikush thotë një fjalë...”
- Ndoshta dikujt mund t’i falen gjynahet nga diçka që ai e urren më tepër.

Kapitulli: “Betimet ndaj Allahut”.

Betimet ndaj Allahut janë në dy forma:

E para: Me mendjemadhësi dhe arrogancë; ky njeri e ngre lart veten e tij, saqë i jep vetes të drejtë të mendojë se Allahu ka detyrime kundrejt tij, e kjo e kundërshton teuhidin e plotë, por edhe mund ta mohojë atë që nga origjina e tij. Ky njeri është kërcënuar me dënimin që ka ardhur në këtë hadith, sepse tregohet arrogant ndaj Allahut të Lartësuar duke gjykuar me atë çfarë ai zgjedh. Ai thotë:

¹ E shënon Muslimi (2621).

² E shënon Ahmedi (2/223 nr. 8292), Ebu Daudi (4901), Ibn Hibani (13/20 nr.5712).

‘Pasha Allahun, nuk do t’i ndodhë kështu filanit’, duke treguar mendjemadhësi e duke i nënçmuar të tjerët. Ai do që gjykimi i Allahut të përputhet me gjykimin i tij, me arrogancë, që Allahu i Lartësuar të bëjë ato që ai mendon. Kjo mendjemadhësi është një lloj arbitrariteti në çështjet e Allahut të Lartësuar dhe në veprimet e Tij, e kjo nuk mund të dalë nga zemra e një besimtari, i cili e madhëron Allahun e Lartësuar.

E dyta: Të betuarit në Allahun e Lartësuar jo me arrogancë, porse ajo gjë që ai mendon është e saktë, për diçka që i ka ndodhur apo për një çështje që do të përballet në të ardhmen. Ky betohet në Allahun e Lartësuar se do të jetë ashtu e kështu, me përlujtje dhe nënshtrim ndaj Allahut, e jo me arrogancë. Për këtë rast ka ardhur hadithi:

“Ka njerëz që, sikur të betohen në Allah, Ai do ua plotësonte”³.

Ata betohen në Allah jo me mendjemadhësi, arrogancë apo për të madhëruar veten, por për shkak të nevojës dhe kërkesës që kanë për Allahun, dhe këtë e përforcon duke u betuar në Allah dhe në emrat e Tij, duke menduar mirë për Allahun e Lartësuar. Kjo lejohet. Ata kanë në zemër adhurimin e Allahut, përlujtjen dhe nënshtrimin, çka e bën Allahun e Lartësuar t’i përgjigjet lutjes së tyre, t’ua plotësojë kërkesat dhe dëshirat e tyre.

Forma e parë është me mendjemadhësi dhe arrogancë, duke e bërë njeriun të mendojë se ai ka arritur aq pozitivë, sa që vepra e Allahut duhet të jetë pasuese e veprës së tij, prandaj tregohet mendjemadh dhe i nënçmon të tjerët. Me këtë shpjegim qartësohet hadithi që ka ardhur në këtë kapitull.

“Xhundub Ibn Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) përcjell se Profeti (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) ka thënë: “Njëherë, një njeri tha: “Vallahi, Allahu nuk e fal filanin!” Allahu i Lartësuar tha: “Kush është ai që betohet në Mua se nuk e fal filanin?!”. Ai që tha ‘Vallahi, Allahu nuk e fal filanin!’, ishte njeri i devotshëm, ndërsa tjetri ishte njeri i shturur. Njeriu që ishte i devotshëm tha: ‘Vallahi, Allahu nuk e fal filanin’, sepse ai tjetri ishte njeri i shturur, i zhytur në gjynahe. Njeriu i devotshëm e shpërfilli atë dhe e mbiçmoi veten e tij, duke menduar se ai, me adhurimin që i bënte Allahut të Lartësuar, kishte arritur pozitivë sa të gjykonte veprat e Allahut, dhe se Allahu nuk ia kthente ato gjëra që ai ia kërkonte, apo mendonte se ai mund të kontrollonte sjelljet e njerëzve. Kjo bie në kundërshtim me vërtetësinë e adhurimit, i cili është: t’i përulesh Allahut të Lartësuar. Prandaj

³ E shënon Buhariu (2703) dhe Muslimi (1675) nga hadithi i Enesit (Allahu qoftë i kënaqur me të).

Allahu i Lartësuar pas saj thotë “Kush është ai që betohet në Mua”, domethënë, kush e mban veten me mendjemadhësi duke u betuar në Mua. Sepse fjala “*jete’el*” do të thotë ‘betim’. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata që betohen se nuk do t’u afrohen grave të veta, duhet të presin katër muaj; nëse pendohen nga betimi, ta dinë se Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë”⁴. Pra, këtu është për qëllim kur betohesh me mendjemadhësi dhe duke mbiçmuar veten.

“Në të vërtetë, Unë e fal atë dhe ta asgjësoj punën tënde”. Allahu e fali njeriun e shthurur dhe ia asgjësoi veprat njeriut që ishte adhurues i madh. Kjo tregon qartë se ç’do të thotë të bësh diçka që bien ndesh me madhërimin dhe teuhidin e Allahut të Lartësuar. Njeriut të shthurur i erdhi mirësia andej nga nuk e priste. Për të u tha një fjalë, që në pamje të parë duke se është e dëmshme, nënçmim dhe përbuzje për të, pasi ashtu kishte gjykuar ai njeri i devotshëm. Kjo fjalë e keqe e cila e lëndoi atë, ishte mirësi e madhe për të, saqë ia fali Allahu gjynahet. Për këtë ka paralajmëruar Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) me këtë kapitull se, kur njeriu sprovohet dhe mundohet, në to ka shkaqe për mirësi të madhe për të. Pra, nuk është domethënës përbuzja e njerëzve, as fjala e tyre e as lëndimi i tyre, dhe as klasifikimi që ata u bëjnë njerëzve, por domethënës është se si qëndron çështja tek Allahu i Lartësuar.

Detyrim për krejt njerëzit është ta madhërojnë Allahun, t’i përulen Atij dhe të mendojnë se ata janë njerëzit më të këqij, derisa zemrat e tyre ta ndiejnë se kanë nevojë emergjente për Allahun e Lartësuar dhe se ata nuk ia kanë dhënë hakun Allahut. Ndërsa për ata që madhërojnë vetët e tyre me fjalë apo lavdërojnë veten e tyre, kjo vepër themi se kjo nuk u takon atyre që e madhërojnë Allahun e Lartësuar, atyre të cilët kanë frikë se mos Allahu ua ndryshon zemrat. Allahu i Lartësuar i ndryshon zemrat dhe i kthen ato si të dojë. Zemra e përulur dhe e penduar është e kujdesur dhe gjithmonë ka frikë se mos ndryshon. Është vigjilente se mos dëbohet, është e vëmendshme se mos shmanget, ka kujdes nga fama, për lëvizjet e saj, duke shpresuar që Allahu i Lartësuar ta çojë deri në vdekje të paturpëruar.

⁴ EL-BEKARE : 226